




Programi i Partneritetit Evropian me Komunitat

Raporti i gjashtë tremujor

1. korrik-30. shtator 2012.



Program finansira EU



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



Sprovodi program



Program finansira EU



Swiss Agency for Development and Cooperation SDC



Sprovodi program



Program evropskog partnerstva sa opštinama

Përmbledhje

Periudha që pasoi pas zgjedhjeve të mbajtura më 6 maj 2012 solli sfida më serioze se sa priteshin. Edhe pse autoritetet lokale janë formuar para marrëveshjes për koalicionin qeverisës në nivel kombëtar, formimi i Qeverisë nga ana e Partisë përparimtare Serbe (SNS), Partia socialiste e Serbisë (SPS) dhe Partia e rajoneve të bashkuara të Serbisë (URS) ka bërë ndryshime në komuna me qëllim që përbërja e koalicioneve lokale qeverisëse të reflektojë përbërjen e koalicionit në nivel kombëtar. Pavarësisht nga fakti se zgjedhjet në program janë paraqitur si rrezik, niveli aktual i këtyre ndryshimeve ka shkaktuar ngadalësim dhe një numër të kufizuar të aktiviteteve.

Megjithatë, zbatimi i programit ka përparuar në mënyrë të vazhdueshme pavarësisht jo-stabilitetit politik: 40% të projekteve janë kryer plotësisht, 28 janë duke u zbatuar siç është planifikuar dhe 27% janë duke u zbatuar me vonesë e që bartin një rrezik të vogël. Më shumë se 90% të projekteve janë duke u zbatuar duke përdorur metodologjinë e ndihmës së pakthyeshme, përmes të cilës komunat kanë një mundësi të rëndësishme për të ndërtuar kapacitetet e tyre. Përveç kësaj, shpenzimi i mjeteve është rritur në shtator, pas pushimit të verës, pra gjatë këtij muaji janë shpërndarë gjithsej 825.352 €.

Arritjet kyçe brenda Komponentës 1 përfshin 16 kontrata të financuara përmes Fondit për pjesëmarrje të qytetarëve 2 (CIF-2), hapjen e zyrës Këshillëdhënëse për qytetarë në Preshevë dhe rindërtimin dhe pajisjen e Këshillit Kombëtar të pakicës shqiptare në Bujanoc. Pas aktiviteteve të përkushtuara në ndërtimin e kapaciteteve të Komisionit të Ivanjicës për Barazi Gjinore, i cili është financuar nga EU PROGRES, komisioni ka marrë një milion dinarë nga Qeveria e Suedisë për projektin e tij të parë.

Në kuadër të Komponentës 2 janë hapur tri vende të punës në Qendrën e Biznes Inkubatorit në Vranjë, është vendosur që shërbimet „gjithçka në një vend“, në Vranjë dhe Leskovac, të vendosen brenda Qendrave të shërbimeve komunale, që do të çojë në përmirësimin e shërbimeve që ato ofrojnë; Surdulica dhe Ivanjica me një temp të shpejtë janë duke përparuar me zbatimin e projektit të Sistemit të menaxhimit të kualitetit. Mbështetja e administratave tatimore ka rezultuar në rritjen e numrit të përgjithshëm të tatimpaguesve të regjistruar në 11 komuna për 12.500 në nivelin kumulativ. Kjo duhet të çojë në rritjen e të të ardhurave nga taksat lokale për rreth 10% gjatë vitit të ardhshëm.

98% e punëve në Zonën e gjelbër në Leskoc brenda Komponentës 3 është përfunduar. Janë përfunduar edhe 15 projekte të vogla infrastrukture. Një nga rezultatet e rëndësishme është që komunat kanë ofruar më shumë se 30 milionë dinarë për bashkë-financimin e projekteve që janë iniciuar dhe përkrahur përmes EU PROGRES.

Kulmi i komponentës së katër ka qenë projekti i brendingut të Ditës së kumbullës në Bllacë, e cila u vizitua gjatë katër ditëve nga gjithsej 100.000 vizitorë gjatë të cilëve Bashkimi Evropian dhe qeveria Zvicerane kanë fituar publicitet të madh. Përpjekjet e përgjithshme për të rritur dukshmërinë e programit kanë rezultuar në publikimin e gati 300 emisioneve në media gjatë tremujorit të tretë të vitit 2012 dmth 100 emisione më shumë se që janë planifikuar për tërë vitin.

Takimi vjetor i Komitetit Drejtues të Programit u mbajt në korrik dhe është përpiluar raporti i dytë vjetor. Është bërë vlerësimi i programit në mes të kohëzgjatjes së tij dhe EU PROGRES është tashmë duke zbatuar rekomandimet nga ajo: Plani i punës është azhuruar, është duke u përgatitur kërkesa



Program finansira EU



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra
Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



UNOPS

Sprovodi program

eu progres

Program evropskog partnerstva sa opštinama

për vazhdimin e programit e cila nuk kërkon shpenzime shtesë, kurse sistemi për monitorim dhe vlerësim do të forcohet.

Ky raport përbëhet nga pesë kapituj dhe Aneksë shoqërues, në këtë raport po ashtu paraqitet situata politike dhe socio-ekonomike në jug dhe jugperëndim të Serbisë, aktivitetet dhe të arriturat, rezultatet menaxheriale dhe administrative si dhe rezultatet e arritura në fushën e rritjes së dukshmërisë.